

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Fillim Skoro, kryetar, Driton Muharremi e Xhevdet Abazi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit M.A. nga fshati Dardani Komuna e Ferizajit, për shkak të veprës penale Rekrutimi për terrorizëm nga neni 139 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe ankesës së mbrojtësit të akuzuarit M.A., të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj PKR.nr.214/2015 datë 25.10.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me 13.12.2016 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe ajo e mbrojtësit të akuzuarit M.A., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj PKR.nr.214/2015 datë 25.10.2016, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykatës Themelore në Ferizaj, me aktgjykimin PKR.nr.214/2015 datë 25.10.2016, e ka shpallur fajtor të akuzuarin M.A., për shkak të veprës penale Rekrutimi për terrorizëm nga neni 139 të KPRK, për çka e ka gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) viteve, ku në dënimin e shqiptuar do të i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 11.02.2015 e tutje derisa aktgjykimi ta marr formën e prerë por jo më shumë se koha e dënimit të shqiptuar me këtë aktgjykim. Obligohet i akuzuari që ti paguaj gjykatës shpenzimet për paushallin gjyqësor në shumë prej 100 euro në afat prej 30 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë kanë paraqitur:

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, për shkak të vendimit lidhur me dënimin dhe ka propozuar që Gjykata e Apelit ta aprovoj në tërsi këtë ankesë ndërsa aktgjykimin e kundërshtuar ta ndryshoj sa i përket vendimit mbi dënim ashtu që të akuzuarit të i shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje më të gjatë.

- Mbrojtësi i të akuzuarit M.A., av. B.S., për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës penale, konstatimit të gabuar e jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së Ligjit Penal, vendimit mbi dënimin shpenzimet dhe paushallin gjyqësor, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e shkallës së parë ta ndryshoj dhe të akuzuarin ta liroj nga përgjegjësia penale dhe veprën penale për të cilën akuzohet ose aktgjykimin e atakuar ta prish dhe lëndën ta kthej në rigjykim.

Gjykata e Apelit e Kosovës e caktoj dhe e mbajti seancën kolegjit konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPP, për të cilën i njoftoj palët. Në seancë prezantuan Prokurori i Apelit S.A., i akuzuari M.A. dhe mbrojtësi i të akuzuarit av. B.S.. Prokurori i Apelit mbeti pranë pretendimeve të dhëna me shkrim PPA/I.nr.612/16 të datës 25.11.2016, me të cilën ka propozuar që të aprovohet ankesa e PSRK-së ndërsa ajo e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pa bazuar. Mbrojtësi i të akuzuarit M.A. av. B.S. theksoi se qëndron pranë pretendimeve ankimore, ndërsa i akuzuari mbështeti fjalën e mbrojtësit të tij.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa nuk është e bazuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.A., me ankesë pretendon se aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.8 dhe par.2 pika 2.1 dhe 2.2 të KPPK, aktgjykimi nuk përmban arsyet për faktet vendimtare, ku faktet vetëm përmenden e nuk sqarohet përmbajtja e tyre gjegjësisht aktgjykimi nuk është i përpiluar në pajtim me nenin 370 par.4 të KPP. Arsyet janë plotësisht të paqarta, ekziston në një masë të konsiderueshme kontradikta e theksuar midis asaj që paraqitet në arsyet e aktgjykimit e që janë kontradiktore me përmbajtjen e shkresave dhe procesverbaleve, deklarimeve të akuzuarve dhe dëshmitareve me përfundimet e nxjerra nga gjykata. Përfundimet e pretenduara të gjykatës së shkallës së parë janë në kundërshtim me provat e administruara të cilat qojnë në një përfundim tjetër. Nuk ka analizë thelbësore në raport me institutin e dashjes. Vlerësimi i së cilës provë duhet orientuar në atë se cili fakt provohet me te apo cili fakt kontestohet, dhe mungesa e një analize në këtë rrafsh paraqet shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale. Gjykata nuk bën analizën e provave veç e veç, nuk arsyeton faktin e besimit apo jo të deklarimeve por nxjerr një konstatim stereotip të fjalëve që në vete nuk përmbajnë arsyet specifike pse i falet besimi një prove e pse provës tjetër. Ekspertiza e realizuar nuk është në përputhje me gjendjen e fakteve lidhur me atë se sa është i inkriminuar i akuzuari për veprën penale që akuzohet. Prokuroria nuk ka arritur që këto rrethana të i argumentoj ndërsa gjykata ti vërtetoj përtej çdo dyshimi të bazuar. Procesverbali mbi bastisjen e banesave dhe personave i dt. 11.02.2015 në zyret e Partisë Politike Lisba është kryer në kundërshtim me nenin 108 par.2 të KPP, sepse gjatë kontrollit ka qenë prezent vetëm një dëshmitar. Procesverbali mbi bastisjen e banesave dhe personave në shtëpinë e të akuzuarit në fshatin ...i dt. 11.02.2015, është marrë në kundërshtim me nenin 107 të KPP pasi që zyrtari policor në rastin e kontaktit të parë me të akuzuarin dhe anëtarët e familjes së tij nuk ka prezantuar -dorëzuar kopjen e urdhër kontrollit me shkrim por një gjë të tillë e ka bërë me gojë. Dëshmitar janë marrë babai i të akuzuarit H.A.dhe vëllai i tij Z.A.të cilët jetojnë në një shtëpi me të akuzuarin. Provat e marrura si ekzaminimi i pajisjeve elektronike, kompjuter, telefona sipas raportit të policisë DKT-DPP 06/-103/679/2015, ku janë 1317 fotografi janë prova qartazi të pa rëndësishme ndërsa gjykata i ka marrë si prova e që paraqet shkelje thelbësore të dispozitës së nenit 259 par.1 të KPP. Pretendon se nuk është trajtuar drejtë gjendja faktike përkatësisht gjendjen faktike e ka vënë nën dispozitat materiale. Prokuroria nuk ka provuar se veprimet ose mosveprimet rrjedhin nga kryerja e veprës penale duke ja përkujtuar se barra e provës bie mbi

prokurorin ndërsa i akuzuari është i liruar nga detyrimi për ta dëshmuar pafajësinë e tij. Asnjë rrethanë faktike nuk qon në konkluzion se M.A. ka qenë pjesë e krimit të supozuar. Nuk ka përgjegjësi penale në mungesë të dashjes dhe të veprimit konkret e që janë elemente qenësore të figurës së veprës penale. Sa i përket cilësimit ligjor të veprës penale është vërtetë plotësisht se M.A. nuk e ka krye veprën penale për të cilën akuzohet. Vlerëson se cilësimi ligjor i veprës penale është i gabuar për faktin se vlerësimi i gabuar i të gjitha çështjeve që lidhen kinse me rekrutim për terrorizëm është nën ndikim qenësor në cilësimin juridik të veprës penale me të cilën ngarkohet i akuzuari M.A.. Gjykata e ka shpall fajtor të akuzuarin duke u mbështetur në dëshminë e dëshmitareve F.LI. dhe N.B. dëshmi këto të cilat nuk ka mundur mbrojtja ti kundërshtoj pasi që këta dy dëshmitar nuk kanë dëshmuar para gjykatës. I është dhënë rëndësi vendimtare deklaramit të akuzuarit të dhënë në prokurori me datë 10.03.2015 pa u bazuar në ndonjë provë materiale. Dëshmia e dëshmitarit F.M. e dhënë në polici është në kundërshtim me dispozitat e KPP-së, sepse i njëjti është keqtrajtuar dhe është detyruar të dëshmojë në favor të akuzuarve të M.A. Nuk është vërtetuar se i akuzuari i ka paisur me bileta B.H., F.I., F.LL. dhe N.B.. Dëshmitarët M.H., A.R. dhe dëshmitari anonim A nuk mund ta kenë cilësinë e dëshmitarëve sepse ata fare nuk e njohin M.A. Vlerëson se deri të shkelja e Ligjit Penal ka aritur për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Gjykata e Apelit me vëmendje ka shqyrtuar aktgjykimin e shkallës së parë, ankesën e mbrojtësit të akuzuarit si dhe shkresat e lëndës dhe vlerëson se aktgjykimi i atakuar me ankesë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. I njëjti ka të paraqitura arsyet për çdo pikë të aktgjykimit, është paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pa vërtetuara. Ka vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse si dhe arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palës mbrojtëse si dhe arsyet me të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështjeje penalo-juridike e veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit. Gjykata e shkallës së parë në aktgjykim ka dhënë arsyet për faktet vendimtare, ka arsyetuar secilën provë veç e veç duke i ndërlidhur me njëra tjetrën dhe duke e vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike. Gjykata e shkallës së parë ka administruar provat si ato materiale ashtu edhe ato jo materiale siç janë prej provave materiale, përmbajtjen e SMS-ve me raportet policore për bisedat telefonike prej datës 01.01.2013 pranuar nga numrat telefonik që i ka përdorur i akuzuari me personat tjerë, raporti i kontrollimit 04 DKT 2014 i datës 11.02.2015 me fotoalbume, lista e dëshmimeve nga Njësia e faranikes të shënuara si D1 dhe D14 si dhe fotoalbumin me fotografi, raporti i policisë lidhur me ekzaminimin e paisjeve elektronike të akuzuarit i dt. 02.11.2015, raporti shtesë mbi të gjeturat e ekzaminimit të telefonit Samsung në pronësi të akuzuarit i dt. 07.12.2015, fotoalbumi i Drejtorisë së Teknikës Kriminallistike, fotografitë e marrura nga paisjet elektronike, raportet nga Kompania.... në Prishtinë, raporti nga policia kufitare ndërsa nga provat personale ka administruar dëshminë e dëshmitares A. R., M.H., F.M., dëshmitarit A, ashtu që për secilën këto prova ka dhënë vlerësimin dhe të gjeturat faktike të gjykatës. Gjendja faktike nga ana e gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar nga dëshmitë e dëshmitarëve të theksuar më lartë e në ndërlidhje me provat materiale po ashtu të cekura më lartë e pjesërisht edhe me mbrojtjen e të akuzuarit, e që të gjitha këto vërtetojnë se i akuzuari u ka bërë thirrje personave të tjerë që të marrin pjesë në aktivitetet e organizatës terroriste ISIS duke propaganduar përmes rrjeteve sociale si dhe verbalisht duke ndikuar tek personat

konkret që të marrin pjesë në këtë organizatë. Kjo është shprehur po ashtu edhe me veprime tjera siç është sigurimi i biletave të udhëtimit përmes linjës ajrore Prishtinë-Stamboll për personat F.I., B.H. dhe N.B. e ku F. dhe B. me datë 07.08.2013 kanë fluturuar në linjën Prishtinë-Stamboll, kanë kaluar në Siri, i janë bashkangjitur organizatës ISIS e që B.H. si pjesëtar i kësaj organizate me 25.03.2014 në shtetin e Irakut përmes aktit terrorist vetëvritet duke vrar edhe 52 persona të tjerë ndërsa F.I. ende gjendet në radhët e kësaj organizate ndërsa N.B. edhe pse e ka siguruar biletën në momentin e fundit e ka ndërruar mendimin dhe nuk i është bashkangjitur kësaj organizate. Kjo është dëshmuar përmes dëshmitarëve A. R., M. H., F.M. dhe dëshmitarit anonim A, e sidomos nga Arjeta, Minirja dhe dëshmitari anonim A kanë përkthyer se B.H. ka qenë person stabil dhe se ndryshime të mëdha në personalitetin e tij kanë filluar pas vitit 2012 kur ka filluar të merret dhe ti përkushtohet rriteve fetare duke u shoqëruar me të akuzuarin M.A., duke e përmendur M.A. se ai është vëlla i tij mysliman dhe i din më së miri dhe se gjatë kontakteve përmes Facebook-ut me F.I. ky i fundit dëshmitarit ja ka dhënë një numër të telefonit duke e udhëzuar se përmes këtij personi dëshmitari mund të i ndihmoj me mjete financiare Faton Ivajës e që gjatë komunikimit F. ishte i kujdesshëm duke mos përdorur emra ku shton “më kujtohet se thojke mos me e përmën emrin e M.A.” e këtë e ka deklaruar dëshmitari A në shqyrtimin gjyqësor. Të njëjtën e ka deklaruar edhe M. H. se Blerimi ndryshimet në personalitet të tij i ka pësuar pasi ka filluar të shoqërohet me të akuzuarin M.A. dhe se pasi ka shkuar B. në Siri, dëshmitarja ka komunikua përmes telefonit dhe Facebookut, dhe që B. i ka thënë se M.A. e ka dërguar në luftë dhe se ai do të hi në këtë luftë pasi që të i kryej do punë. Ka shtuar se i akuzuari M.A. në Facebook i ka dhënë komente dhe komplimente kur Blerimi ka postuar foto me uniformë ushtarake nga Siria, kurse dëshmitarja Arjeta po ashtu ka deklaruar se ka pa komplimente nga M.A. dhe se kur e njëjta ka dashur ta kontaktoj M.A. B. i ka thënë që të mos bisedoj me të sepse ai ja don të mirën atij e po ashtu nga B. kishte kuptuar se në Siri B. kishte shkuar me F.I.. Shoqërimin e të akuzuarit me B. dhe F. nuk e ka mohuar as vetë i akuzuari porse thekson se me ta vetëm është shoqëruar si me shumicën e vëllezërve mysliman por që ai nuk ka shprehur interesim për të marr pjesë në këtë luftë. Me F.I. ka deklaruar se njihet prej vitit 2003 dhe me të është takuar zakonisht te Xhamia e Madhe në Ferizaj dhe pasi F. ka shkuar në Siri i ka shkruar të akuzuarit në Facebook dhe e ka njoftuar që gjendet në Siri duke e ftuar edhe katë që të shkoj atje. I akuzuari ka deklaruar në polici me datë 11.02.2015 se dy javë para se Blerimi të shkoj në Siri është takuar me te në gusht të vitit 2013 dhe e ka njoftuar se së shpejti do të nisjet për të marrë pjesë në luftën e Sirisë dhe pas tri jave e ka njoftuar në Facebook se ka mbërritur në Siri dhe se nuk e ka mohuar faktin se pastaj ka komunikuar me B. përmes Facebookut. Veprimet inkriminuese të akuzuarit vërtetohen edhe përmes dëshmitarit F.M. i cili ka deklaruar se është shoqëruar me të akuzuarin dhe se kanë shkuar në agjencionin ...në Prishtinë për të pyetur për biletat e aeroplanit pasi që interesoheshin për të shkuar në vizitë në Umre, ndërkaq në procedurë paraprake ka theksuar se me të akuzuarin kanë shuar dy herë në agjencionin...porse i akuzuari ka hy në agjencion por se ai nuk e din se a ka nxjerr biletë apo jo, që nuk e mohan as vetë i akuzuari këtë porse i akuzuari thekson se kanë shku me insistimin e F. M. dhe se F. ka hyr brenda kurse i akuzuari ka pritur jashtë agjencionit. Po ashtu nga vetë dëshmia e të akuzuarit ku thotë se F.I. nuk ka qenë i angazhuar në atë drejtim sepse nuk ka pasur shumë njohuri për fenë islame vërteton faktin e ndikimit në mënyrë indirekte edhe te personi F.I.. Sa i përket dëshmitarit N.B., i njëjti në deklaratën e dhënë në polici e që në shqyrtim gjyqësor ka refuzuar të dëshmoj, ka thënë se me fillimin e luftës në Siri ka kontaktuar në

Facebook me persona të ndryshëm të quajtur “vllaznia muslimane”, siç janë F.Ll., M.A., P. M. etj., dhe kishte vendosur për të shkuar në luftë në Siri, ka komunikuar me F.Ll. i cili i ka thënë se biletën ja nxjerrin vllaznia muslimane, dhe pas dërgimit të dhënave F. përmes Facebookut e ka njoftuar se biletën ta ka paguar M.A. dhe F.M. me vllazërit musliman dhe e kanë njoftuar për detajet e fluturimit. Ka theksuar se në momentin e fundit është bërë pishman dhe të nesërmen përmes facebookut ka kontaktuar me M.A. në profilin e tij dhe ka kërkuar sqarime se pse dëshmitari nuk udhëtoj për në Siri duke e quajtur Munafik- pa besimtar, i pa fe, frikacak dhe e ka kërcënuar se do të vjen në Pejë dhe do ta poshtëroj në prani të vllaznive dhe ka kërkuar shumën prej 60 eurove për biletën e paguar, mirëpo ky e ka njoftuar se parat nuk ja kthen meqë biletën nuk e ka shfrytëzuar. Ka theksuar se i akuzuari M.A. i ka thënë të ketë kujdes për shkaqe sigurie të mos komunikoj për këto gjëra përmes Facebookut duke e udhëzuar që të bisedoj me F. Ll. Ka theksuar se pastaj M.A. është takuar me F. M. te Xhamia e Madhe në Prishtinë lidhur me çështjen e biletave të udhëtimit dhe shkuarjen e dëshmitarit dhe F. Ll. në luftën e Sirisë. Me të drejtë trupi gjykues ka vlerësua dëshmitë e këtyre dëshmitarëve duke i ndërlidh me provat tjera materiale për ta vërtetuar gjendjen faktike dhe se i akuzuari F.M. ka vepruar me një kujdes të veçanti gjatë komunikimeve përmes rrjeteve sociale me persona të tjerë duke propaganduar me qëllim që të i bashkëngjiten organizatës ISIS, nga dëshmitari N.B. por edhe nga kontaktet e tjera telefonike duke shkruar “mos harro sante fshij qato sene qka i ki, qatëherë mas jacisë vi” e kjo shënohet në SMS-in e datës 25.06.2013 në ora 11,42 minuta dërguar nga i akuzuari në numrin telefonik 044/516-210. Po ashtu gjendja faktike është vërtetuar edhe nga masat e fshehta të hetimit dhe vëzhgimit të cilat janë marr konform dispozitave të procedurës penale e që kanë vërtetuar gjendjen faktike si dhe përkrahjen e të akuzuarit për organizatën terroriste ISIS dhe luftën e kësaj organizate në Siri. I akuzuari M.A. nga telefoni i tij me numër 044////përcjell SMS në umrin 044//// me përmbajtjen “edhe një shqiptar nga Gostivari shehit, inshallah edhe 55 të tjerë, Allahu ju ndihmoftë vëllezërve tanë, ndërsa të nesërmen mediat kanë publikuar lajmin për shqiptarin nga Gostivari të vrarë në Siri. Në SMS-ën tjetër të datës 19.10.2013 në numrin 045//// ka këtë përmbajtje “O alejkum selam vëlla, Allahu të nderoft, edhe ty për hajr Bajrami, dhasht Allahu inshallah bajramin tjetër me e prit në Sham-ISIS-Islamik-State of Iraq and Ash-Sham, ndërsa me datën 01.10.2014 në ora 23:22 i akuzuari dërgon SMS në numrin 045//// me këtë përmbajtje: “O vëlla kjo është fitne nuk ban mi hang kto fre” na e dim që fitorja është afër dhe kjo fitne e ka zanafillën prej Asadit, e jona është me bo dua për këtë musibed”, e që nga kjo përmbajtje haptas shihet përkrahja e të akuzuarit për luftën e ISIS-it dhe zgjerimin e shtetit islamik e që i demanton pretendimet e mbrojtjes se i njëjti nuk është fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë. Pas analizimit të ekzaminimit të paisjeve elektronike të sekuestruara nga i akuzuari, është konstatuar se është gjetur 1317 fotografi, video dhe audio-incizime që përkrahin organizatën terroriste ISIS, mënyrën e veprimit të kësaj organizate fotot e ushtarve të ISIS-it, foto të akuzuarit me armë dhe stema e shenja të shtetit islamik si dhe udhëzime të ndryshme të profilit të hapur “Toka e Khilafetit” duke e bërë kështu propagand intenzive për luftën e ISIS-it dhe për të rekrutuar ushtarë të ri në këtë organizatë siç ka ndodhur me B. , F. dhe N. të cilëve u ka siguruar bileta të aeroplanit për në Stamboll, që kanë kaluar në Siri dhe i janë bashkuar ISIS-it përveç N. i cili ka ndërruar mendjen dhe nuk ka udhëtuar. Nga ekzaminimi i Facebookut të akuzuarit, i njëjti ka rreth 70 shokë, e që disa prej tyre ende gjenden në luftë të Sirisë, disa të vrarë në atë luftë e disa të dënuar apo të akuzuar për vepra apo për veprimtari terroriste

në organizatën ISIS. Këto pajisje janë gjetur edhe citime nga lideri i ISIS-it Ebu Beker El Bagdat, janë gjetur edhe fotografi të pasaportës të shtetit islamik si “nderi i muxhahidit është i shtrenjtë, shteti islam po triumfon edhe pse këtë ti nuk e dëshiron i ka dhënë Allahu bereqet, do të hyj në çdo shtet e çdo shtëpi, do të ngritët flamuri i zi”, është konstatuar po ashtu edhe videoinçizimi i titulluar “ djali im ka vrrar 255 njerëz në Irak dhe unë jam babai më krenar në Botë”. I akuzuari ka postua në facebook fotografi të trurit të njeriut me këtë koment “bojm shpëlarjen e trurit nga kjo gjendje në këtë gjendje, dhe shihen dy fotografi të trurit njerëzor njëra e postuar me 10.01.2015 që përshkruan në mënyrë ilustrative raportet mes të akuzuarit dhe vllazërisë muslimane ndërsa gjatë ekzaminimit nga shtëpiza e kompjuterit të B. H. janë konstatuar 30 fotografi të akuzuarit M.A.. Edhe i akuzuari M.A. në mbrojtjen e tij të dhënë në prokurori nuk ka mohuar faktin se ka qenë i njoftuar për vendimet e këtyre personave për të shkuar në Siri si dhe lidhur me mënyrën e shkuarjes së tyre e që këtë e ka deklaruar me datë 10.03.2015 në prani të mbrojtësit të tij para prokurorit deklaratë kjo e përshkruar detajisht në faqen 15 të aktgjykimit e shkallës së parë. Se F.I. dhe B.H. me datë 07.08.2010 kanë udhëtuar përmes Prishtinës në Stamboll është vërtetuar me prova dhe nga raporti i Kompanisë ... dhe nga raporti i policisë kufitare. Sa i përket dëshmitarit F. L., i njëjti ka refuzuar të dëshmoj, mirëpo veprimet inkriminuese të të akuzuarit vërtetohen përmes SMS-ve të cilët ky person ia ka dërguar të akuzuarit M.A. në numrin 044/// me përmbajtje “Selamunealejkum ma ban hallal por nuk po muj me i siguraa paret për biletë edhe katër ditë. Hajr inshalla, e që ky person ka udhëtua për në Siri me 08.12.2013 dhe i është bashkangjitur ISIS-it ndërsa pas kthimit tani gjendët në vuajtje të dënimit për vepër penale terroriste. Është vërtetuar se i akuzuari ka grumbulluar fonde për ISIS, dhe siç ka ndodh kur personi i quajtur Kenan Teneqja nga Belgjika ka dërguar në llogari bankare të M.A.t 100 euro me porosi “Selam alejkum vlla, hej nesër se ti janë qel këtu Raiffeisen bank të qoj sms edhe shko merri nja 100 euro për në Siri, ok... Allahu iu ndihmoftë me kontribua për Shamin...” e që nuk është mohuar nga i akuzuari por që ka deklarua se këtë shumë e ka hargjuar bashkë me aktivistët, për shpenzimet e tyre me rastin e grumbullimeve të sendeve, veshmbathjeve etj, për popullin e Sirisë. Gjykata ka vlerësuar po ashtu edhe mbrojtjen e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij të cilët pretendojnë se i njëjti nuk ka krye veprën penale për të cilën akuzohet sepse nuk është provuar fajësia me asnjë provë, me të drejtë trupi gjykues i shkallës së parë ka vlerësuar se një pretendim i tillë nuk qëndron dhe nuk është bazuar në ndonjë provë të vetme dhe se me të drejtë është vlerësuar si përpjekje e mbrojtjes për të ju shmangur përgjegjësisë penale. Me të gjitha provat të cilat u cekën më lartë kanë provuar faktin se i njëjti ka përkrahur intenzivisht ideologjinë e organizatës terroriste ISIS, këto ide të tij i ka përhapur në forma siç edhe u cekë më lartë, ka propagandua luftën e kësaj organizate duke u bërë thirrje të tjerëve që të rreshtohen në radhët e ISIS-it dhe të luftojnë në Siri e siç u vërtetua më lartë i njëjti ka arritur që së paku 4 prej tyre ti bind për të iu përgjigjur thirrjes së të akuzuarit për të shkua në radhët e kësaj organizate, ka ndikuar dhe ka ndihmuar këtyre personave për të udhëtuar në Siri, e që gjitha këto tregojnë të kundërtën e asaj që pretendon mbrojtja dhe se kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit M.A. ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale Rekrutim për terrorizëm nga neni 139 i KPRK-ës. Pretendimet e mbrojtjes se aktgjykimi është i mbështetur në prova të pa pranueshme gjegjësisht sa i përket keqtrajtimit të dëshmitarëve, provave të pa rëndësishme, të njëjtat nuk janë provuar me asnjë provë që do ta kishin vërtetuar një fakt të tillë e që do të kishte pastaj si pasojë anulimin e këtij aktgjykimi ndërsa pretendimi se disa dëshmi të dëshmitarëve nuk vërtetojnë asgjë

në raport me veprimet inkriminuese të akuzuarit, për të njëjtat kjo gjykatë i analizoi dhe i vërtetoi në pjesën e mësipërme të këtij aktgjykimi duke ia dhënë vlerën provuese secilës prej këtyre provave.

Meqenëse në aktgjykimin e shkallës së parë nuk kemi shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nuk kemi as shkelje të Ligjit Penal në dëm të akuzuarit e që do të kushtëzonte anulimin e këtij aktgjykimi.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënim, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe asaj të mbrojtësit të akuzuarit av.B.S., nuk janë të bazuara. Në ankesën e Prokurorisë dhe mbrojtësit të akuzuarit, nuk ceket ndonjë rrethanë e re e që kishte me ndikuar në dënimin e shqiptuar apo të cilën nuk e ka pasur të njohur gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të rrethanave që ndikojnë në lartësinë e dënimit, por Prokuroria thekson se dënimi i shqiptuar nuk i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe vlerëson është dashur që të akuzuarit të i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje më të gjatë, pasi i akuzuari është përgjegjës kryesor dhe direkt për shkuarjen e disa shtetasve të Kosovës në Siri, për t'iu bashkuar ISIS-it dhe se njëri prej tyre është vetëvra duke vrarë edhe 52 njerëz, ndërsa mbrojtja edhe pse në ankesë si bazë ankimore ka theksuar edhe vendimin mbi dënim të njëjtin nuk e ka elaboruar, mirëpo gjykata sipas detyrës zyrtare të njëjtin e ka vlerësuar ashtu që duke i pasur parasysht të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që i ka konstatuar dhe vlerësuar drejtë gjykata e shkallës së parë, si më parë i pa dënuar, prind i tre fëmijëve ndërsa si rrethanë rënduese veprimin e të abuzuarit duke i ftuar të tjerët dhe duke i inkurajuar dhe ndihmuar për të udhëtuar në shtetin e Sirisë për tu radhitur në radhët e organizatës terroriste ISIS duke i rekrutuar e që pasojat e këtyre veprimeve dhe personave të rekrutuar ishin shumë të mëdha në radhë të parë ndaj vlerës së mbrojtur-jetës së njeriut, vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarve si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.654/2016, më 13.12.2016

Procesmbajtësi,
Eroll Gashi

Kryetari i kolegjit- gjyqtari
1. Fillim Skoro _____

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi _____

3. Xhevdet Abazi _____